



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MBI PROGRAMIN PASUNIVERSITAR MASTER NË GREQI: “STUDIME PËR EUROPËN JUGLINDORE”

Në kuadër të Programit “*STUDIME PËR EUROPËN JUGLINDORE*” (*SEE Studies*), Universiteti Kombëtar Kapodistrian i Athinës ka hapur procedurat e aplikimit pranë Fakultetit të Shkencave Politike dhe të Administrimit Publik (Faculty of Political Science & Public Administration University, of Athens) për vitin 2019-2020. Programi pasuniversitar “Studime për Evropën Juglindore” (*SEE Studies*) është një program 1 (një) vjeçar intensiv në Master. Universiteti i Athinës parashikon të pranojë deri në 25 (njëzet e pesë) studentë e studiues ndërkombëtarë, të cilët janë diplomuar në fushat e shkencave politike dhe humane.

Pjesëmarrja në këtë program synon të promovojë mirëkuptimin e ndërsjellë për marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe për bashkëpunimin ndërkufitar akademik dhe shkencor. Në bazë të natyrës së tij ndërdisiplinore, ky program synon, gjithashtu, të ofrojë një kuptim sa më të plotë për çështjet thelbësore, sociale, politike dhe ekonomike të vendeve të Evropës Juglindore duke inkurajuar pjesëmarrjen e studentëve nga e gjithë bota. Sot, ai funksionon si një Program autonom pasuniversitar pranë Fakultetit të Shkencave Politike dhe Administratës Publike të Universitetit të Athinës. Për sa më sipër, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentet sipas listës në vijim:

1. Formularin e aplikimit, i cili do të shkarkohet nga faqja e internetit për Programim “*SEE Studies*” <http://www.see.pspa.uoa.gr/how-to-apply.html>;
2. Planin e studimit për fushën e kërkimit në anglisht (500 fjalë maksimumi);
3. Kopjen e noterizuar dhe të legalizuar pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të diplomës ose të dokumenteve të ngjashëm që vërtetojnë mbarimin e programit të studimit të nivelit të parë (bachelor);
4. Kopjen e noterizuar dhe të legalizuar pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të listës së notave;
5. Dëshminë për njohuritë e gjuhës angleze në nivelin C2;
6. Dy letra rekomandimi në gjuhën angleze ose greke, të cilat duhet t'i bashkëngjiten aplikimit në një zarf të mbyllur me firmën dhe vulën e institucionit përkatës;
7. Fotokopjen e dokumenteve të tjera mbështetëse, nëse ka, si: certifikata për kualifikime të ndryshme apo për veprimtari kërkimore;
8. Kandidatët e suksesshëm, të cilët nuk janë diplomuar pranë Universiteteve të Greqisë, pasi të kenë marrë miratimin nga Universiteti i Athinës për programin “*SEE Studies*”, mund të

bëjnë njohjen e diplomës pranë Qendrës së Informacionit për Njohjen Kombëtare Akadematike “Hellenic Naric” (e cila lëshon certifikatën për njohje të diplomave të huaja) dhe që gjendet në adresën: <http://www.doatap.gr>;

9. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat përkatëse;

Dokumentet e mësipërme duhet të përkthehen në gjuhën greke ose angleze. Në rast pranimi në programin “SEE Studies”, kandidatëve mund t’iu kërkohen përkthimet zyrtare në gjuhën greke vetëm për procedurat e regjistrimit në Universitetin e Athinës.

Nënvizojmë se studentët shqiptarë që nuk përfitojnë bursë ose ndihme ekonomike mund të aplikojnë për heqjen e tarifës së studimit në këtë program.

Materialet informues dhe formularët e aplikimit gjenden bashkëlidhur këtij njoftimi. Për detaje të tjera, kandidatët mund t’i referohen edhe adresave të mëposhtme të internetit:

<http://www.see.pspa.uoa.gr/>; <http://www.pspa.uoa.gr/>.

Lidhur me kushtet dhe procedurat e përzgjedhjes kandidatët mund të kontaktojnë direkt me Dr. Anna Vallianatou, Administratore e Sekretariatit për Programin Pasuniversitar (SEE Postgraduate Secretariat) të Universitetit të Athinës në Greqi sipas adresës së mëposhtme:

Dr. Anna Vallianatou, Programme Administrator

SEE Programme Secretariat

Tel: +30 210 368 8965

Fax: +30 210 368 8966

Komiteti pranë Sekretariatit për Programin Pasuniversitar “SEE Studies” do të përzgjedhë kandidatët përmes shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura. Kjo procedurë do të shoqërohet edhe me intervista direkt me kandidatët.

Nënvizojmë se aplikimet duhet të dorëzohen me postë ose, personalisht, brenda datës deri në datën **15 qershor 2019** pranë Sekretariatit të Programit në adresën:

Programme Secretariat

nr. 6, Themistokleous St. (second floor - Office 7)

10678 Athens,

Greece.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS